



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2020, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike e ERE-s, dhe u shpreh për çështjet si më poshtë:

1. Mbi miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a. për marrjen e autorizimit të ERE-s për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë në favor të bankës OTP
3. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a., për barrësim të aseteve (makineri dhe pajisje) në favor të “OTP Albania” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të Hec-it “Dardha 1”.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” për rinovimin e licencës nr. 316, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 140, datë 21.11.2015.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” për rinovimin e licencës nr. 317, seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 141, datë 21.11.2015.